

Kërkesë për shpalljen e njoftimit publik

Bazuar në urdhërin me nr. 73, datë 07.02.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për përzgjedhjen e ambientit privat që do të merret me qera nga ana e Bashkisë Durrës për t’u përdorur si zyra për Njësinë Administrative Nr. 2”, në mbështetje të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligji nr. 8561, datë 22.11.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar dhe Shkresës së Njësisë Administrative nr. 2 me nr. 35 prot, datë 27.01.2023.

Për sa më lart grupi i punës, duke marrë parasysh numrin e punonjësve dhe detyrat funksionale që do të kryhen në këto ambiente, vlerësoi që pasuria që kërkohet të merret me qira, të përmbush këto kritere:

- Të jetë e përshtatshme dhe të përmbajë sipërfaqen e nevojshme për 4 zyra të cilat do të përdoren për; zyrën e administratorit dhe inspektorëve, zyrën e administratorit të ndihmës dhe përkrahjes sociale, zyrën e gjëndjes civile.
- Të ketë një ambient për pritjen e qytetarëve si dhe tualetin.
- Ambienti që do të merret me qira të jetë brenda territorit të Njësisë Administrative Nr.2.
- Të ketë një sipërfaqe duke filluar nga 120 m².
- Afati i dorzimit të ofertave është 15 ditë mbas publikimit në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës.

Dokumentacioni që do të paraqesin konkurentët janë:

- Kërkesa për dhënien me qira ku do të deklarohet **oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë.**
- Kartën e identitetit.
- Dokumentin e pronësisë të njehsuar me origjinalin.
- Deklaratë nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka proces gjyqësor në lidhje me ambientin.
- Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumantacionin e dorëzuar.
- ***Paraqitja e dokumentacionit do të kryhet pranë Bashkisë Durrës, në katin e parë, në zyrën e Marrëdhënieve me Publikun, me datë 27/02/2023 dhe datë 28/02/2022.***

Duke Ju falenderuar,